

**MIRATOI**

**MINISTRI**

**Ylli PANGO**

## **R R E G U L L O R E**

### **PËR**

### **KRITERET DHE RREGULLAT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTËVE E AGJENCIVE TË UDHËTIMIT DHE TË OPERTORËVE TURISTIKË**

#### **KREU I**

#### **SUBJEKTET DHE FUSHA E VEPRIMIT**

##### **Neni 1**

1.Objekt i kësaj rregulloreje janë të gjithë personat fizikë/juridikë që dëshirojnë të ushtrojnë ose ushtrojnë veprimtari turistike si agjentë udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operatorë turistike.

2.Në këtë rregullore përcaktohen të drejtat dhe detyrimet që kanë subjektet që kërkojnë të çertifikohen për të ushtruar veprimtaritë e mësipërme në territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe kriteret dhe rregullat për çertifikim.

##### **Neni 2**

Asnjë subjekt nuk lejohet të ushtrojë veprimtari turistike si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik nëse nuk është i pajisur me çertifikatë nga Ministri i TKRS.

##### **Neni 3**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË TURISTIKE**

Objekt i veprimtarisë turistike si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik, konsiderohen ;

Shërbimet turistike ndaj klientëve turistë vendas dhe të huaj, individualë ose të organizuar në grupe, të programuara paraprakisht ose sipas dëshirës së klientëve turistë dhe kryesisht :

- a.- organizimi i udhëtimeve për pushime individuale ose kolektive,
  - organizimi i pritje-përcjelljes së turistëve, shërbimi i guidës, përkthyesit, etj.
  - organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente historike dhe kulturore, ekskursione në natyrë, shfaqje dhe spektakle muzikore ose kulturore etj.
  - dhënia e informacioneve për udhëtime dhe pushime turistike.

- b- rezervimi i vendeve të fjetjes në njësitë akomoduese turistike, si dhe porositja e ushqimit në bar - restorante turistike,
- rezervimi i vendeve në mjetet e transportit turistik, ose vënia në dispozicion me qera pjesore ose të plotë e këtyre mjeteve.

c.-ofrimi dhe shitja e paketave turistike

Paketa turistike është një kombinim i parapërgatitur i jo më pak se dy prej shërbimeve të mëposhtëme, kur shitet ose ofrohet për shitje dhe kur shërbimi mbulon një periudhë për më shumë se 24 orë ose përfshin një natë akomodim.

- Transport
- Akomodim
- Shërbime të tjera turistike të pavarurara nga transporti dhe akomodimi dhe që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të paketës, që do të përfshihen në këtë kombinim të parapërgatitur,dhe kur këta komponentë janë faturuar si zëra të veçantë.

#### **Neni 4**

#### **ELEMENTËT E KONTRATËS**

Në zbatim të ligjit nr 9734 date 14.05.2007 " Për turizmin " organizatori në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes agjentit/agjencisë siguron, në varësi të natyrës së paketës së ofruar, një kontratë me klientin turist, e cila së paku të ketë këta elementë :

1. destinacioni ose destinacionet e udhëtimit, kohën e qëndrimit, datat ;
2. mënyrat, karakteristikat dhe kategoritë e transportit që do të përdoren dhe datat, kohën e nisjes dhe të kthimit. Kur paketa përmban ndalesa tranziti në një qytet tjetër ose me destinacion një qytet tjetër kjo duhet të pasqyrohet e saktë në kontratë ;
3. kur paketa përfshin akomodimin, duhet të përmbajë vendndodhjen, kategorinë turistike dhe kushtet kryesore të klasifikimit turistik bazuar në ligjet e atij vendi ku bëhet akomodimi ;
4. planin e ushqimit ;
5. të përcaktohet koha maksimale për anulimin e udhëtimit në rast se nuk përmbushet numri minimal i planifikuar për paketën i cili i është bërë i njohur më parë klientit turist ;
6. itinerari ;
7. vizitat, eskursionet ose shërbimet e tjera të cilat janë përfshirë në çmimin total të rënë dakord për paketën ;
8. emrin, adresën e organizatorit, shitësit dhe të siguresit të paketës ;
9. çmimi i paketës, i cili mund të jetë dhe i detajuar sipas zërave të kontratës dhe ku të shprehet qartë përfshirja ose jo e taksave në paketë ;
10. faturën dhe mënyrën e pagesës ;
11. kërkesa të veçanta të pa parashikuara në paketë, të cilat konsumatori ia ka paraqitur organizatorit ose shitësit në momentin kur ka bërë rezervimin dhe të dyja palët kanë rënë dakord ;
12. periudha në të cilën konsumatori mund të bëjë ankimim në rast se nuk janë përmbushur elementët e kontratës ;

Të gjitha kushtet e kontratës janë të shkruara në gjuhë të thjeshtë, lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori dhe i komunikohen atij para nënshkrimit të kontratës.

Një kopje e kontratës i jepet konsumatorit.

Sugjerimet në lidhje me kontratën nuk merren parasysh nëse konsumatori nuk i ka bërë të njohura ato 14 ditë para nënshkrimit të kontratës.

Një shitës e ka të detyrueshme dhënien me shkrim të kushteve të kontratës.

Nëse një konsumator nuk dëshiron të vazhdojë sipas kushteve të kontratës mund ta transferojë atë te një person tjetër i cili është dakord me kushtet e kësaj kontrate. Konsumatori duhet ti paraqesë organizatorit ose shitësit qëllimin e transferimit të këtij rezervimi përpara datës së nisjes, e përcaktuar më parë.

Kur një transfertë është bërë në përputhje sa më sipër të dyja palët në prani të organizatorit/shitësit kryejnë procedurat e nevojshme bazuar në pikat e kontratës.

Cmimi i përcaktuar në kontratë nuk ndryshon 20 ditë përpara datës së nisjes.

#### **Neni 5**

Për kryerjen e shërbimeve turistike, përfshirë në objektin e veprimtarisë së saj, agjencia e udhëtimit, agjenti i udhëtimit, tur operator hyn në marrëdhënie dhe lidh marrëveshje kontraktore vetëm me subjekte juridike ose fizike, vendas ose të huaj, të liçencuara/çertifikuara nga MTKRS, të cilët i kryejnë ose i ofrojnë shërbimet e ndryshme turistike edhe drejtëpërdrejtë.

### **KREU II**

#### **STRUKTURA PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURAT PËR ÇERTIFIKIM, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË TURISTIKE**

#### **Neni 6**

Në zbatim të VKM nr 601, datë 12.09.2007 “Për përcaktimin e standarteve, kritereve, rregullave të liçencimit, procedurave për aplikim, ripërtëritje, transferim dhe heqje liçence në fushën e shërbimeve turistike”, struktura përgjegjëse për çertifikim në MTKRS është Sektori i Standarteve dhe Statistikave pranë Drejtorisë së Tregut Turistik dhe Statistikave.

#### **Neni 7**

Sektori që mbulon aktivitetin e çertifikimit të veprimtarive përveç sa parashikohet në VKM, ka detyrën funksionale si më poshtë:

- marrjen në dorëzim të kërkesës me dokumentacionin shoqërues, si dhe dhënien e sqarimeve të nevojshme për plotësimin e tij sipas kritereve të VKM dhe kërkesave të kësaj rregulloreje,

- orientimin, ndjekjen dhe mbikqyrjen e veprimtarisë turistike për ushtrimin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, etikën në turizëm, me kërkesat profesionale bashkëkohore në sektorin turistik,
- përgatitjen e çertifikatës
- i propozon Komisionit të Standarteve të Turizmit, për heqjen e çertifikates në rastin e shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të ligjit nr.9734 datë 14.05.2007 "Për turizmin ", akteve nënligjore në zbatim të tij dhe kësaj rregulloreje.

### **Neni 8**

Procedurat administrative për pranimin dhe vlerësimin e kërkesave të subjekteve për çertifikimin për ushtrimin e veprimtarisë turistike, dhënien, ripërtëritjen, refuzimin, heqjen e çertifikatës përcaktohen sipas VKM nr 601, datë 12.09.2007 “Për përcaktimin e standarteve, kritereve, rregullave të liçencimit, procedurave për aplikim, ripërtëritje, transferim dhe heqje liçence në fushën e shërbimeve turistike”

### **Neni 9**

Çertifikata përmban këto të dhëna: objekti i çertifikatës, emrin e personit juridik ose fizik; emrin e drejtuesit; adresën e selisë qendrore dhe të filialeve; datën e lëshimit dhe afatin e përdorimit.

## **KREU III**

### **KRITERET DHE KUSHTET PËR ÇERTIFIKIMIN E VEPRIMTARIVE SI AGJENT UDHËTIMI, AGJENCI UDHËTIMI DHE OPERATOR TURISTIK**

### **Neni 10**

Kërkesa për pajisjen me çertifikatën e ushtrimit të veprimtarisë turistike si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik bëhet nga drejtuesi ligjor ose nga personi i autorizuar prej tij.

- Certifikata jepet në emër të personit fizik/juridik.
- Subjekti i çertifikuar ka të drejtë të ketë edhe filiale duke i deklaruar ato që në fillim të aktivitetit.
- Për ushtrimin e veprimtarisë turistike si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik në kushte normale pune, për të kontaktuar dhe kryer shërbime të ndryshme me klientelën, subjekti kërkues duhet të ketë në pronësi ose qiramarrje një zyrë me dy ambjente me një sipërfaqe të përgjithshme jo më pak se 16m<sup>2</sup> si dhe pajisjet e nevojshme për komunikim si telefon, faks dhe kompjuter etj.

### **Neni 11**

Drejtuesi teknik (ligjor ose i punësuar me kontratë) ose administratori duhet të zotrojë aftësitë e nevojshme profesionale për drejtimin, organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë turistike, të vërtetuara me dokumente, si vijon:

- diplomën e arsimit të lartë ,
- dëshmi për përvojë pune ose kualifikim profesional në fushën e turizmit.

Personeli operues duhet të jetë i specializuar në kryerjen e veprimtarive dhe shërbimeve turistike. Për këtë duhet të paraqiten dokumentet si vijon:

- deftesën/diplomën e arsimit të mesëm profesional ose të përgjithshëm
- kontratë punësimi sipas Kodit të Punës.
- leje qëndrimi për punonjës me shtetësi të huaj.

### **Neni 12**

Subjekti fizik/juridik, për marrjen e certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë turistike si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik duhet të paraqesë dokumentat fotokopje, si më poshtë:

- 1.formularin-tip më të dhënat e përgjithshme, i plotësuar dhe nënshkruar rregullisht prej përfaqësuesit ligjor të subjektit kërkues, të shoqëruar me dy fotografi të drejtuesit sipas modelit, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
- 2.vendimin e Gjykatës për regjistrimin si person fizik/juridik me objekt veprimtarie, ndër të tjera edhe si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik.
- 3.dokumentat vërtetues për kualifikimin profesional për drejtuesin, për subjektet që kanë personel operues dokumentat vërtetues për kualifikimin profesional të tyre.
- 4.dokumentin vërtetues për pronësinë ose qiramarrjen e ambjenteve të zyrave (selinë qendrore dhe zyrat përfaqësuese filiale), gen-planin si dhe fotografi për ambientet dhe reklamën.
- 5.kërkesën me shkrim drejtuar Ministrit
- 6.formularin e autodeklarimit sipas VKM – së Nr.601, datë 12.09.2007

## **KREU IV**

### **KËRKESAT PËR RIPËRTËRITJEN E ÇERTIFIKATËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE SI AGJENT UDHËTIMI, AGJENCI UDHËTIMI DHE OPERATOR TURISTIK**

### **Neni 13**

Kërkesën për rinovimin e certifikatës përveç dokumentave si në nenin 11 e shoqërojnë edhe :

- Vërtetimi nga ZSHT që nuk kanë detyrime të papaguara nga vendosja e gjobave për kundravajtjet administrative.
- Të ketë ushtruar veprimtarinë jo më pak se një vit.

## **KREU V**

### **HEQJA E SË DREJTËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË**

#### **Neni 14**

Heqja e së drejtës për ushtrimin e veprimtarisë turistike si agjent udhëtimi, agjenci udhëtimi dhe operator turistik propozohen nga ZSHT dhe Drejtoria e Tregut Turistik dhe Statistikave, shqyrtohet në KST dhe miratohet nga Ministri i TKRS. Vendimi i marrë i njoftohet subjektit përkatës dhe organeve tatimore ku subjekti është i regjistruar.

#### **Neni 15**

Në rastin kur subjekti i çertifikuar kërkon të mbyllë aktivitetin duhet të paraqesë

- Kërkesën me shkrim
- Të dorëzojë çertifikatën origjinale